



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**

Nr. 361 prot.

Tiranë, më 21 .06.2021

**V E N D I M**

Nr. 3 , datë 15.06.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E HARTAVE TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET PËR  
DISA ZONA TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

Në mbështetje të pikës 11, të Kreut 2, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet”, pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e hartave të rrezikut nga përmytjet për disa zona të basinut ujor Drin-Bunë, sipas aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, bashkitë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e

Ujësjetillës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GERTA LUBONIA**